

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

**“HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**



Krenare Luma

***POETIKA E ROMANIT EKZISTENCIALIST***  
***FRANCEZ***

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2020

**UNIVERSITY OF PRISTINA**

**“HASAN PRISHTINA”**

**FACULTY OF PHILOLOGY**



**KRENARE LUMA**

**THE POETICS OF THE FRENCH  
EZISTENTIALIST NOVEL**

Doctoral Thesis

Pristina, 2020

## **Rezimeja**

Sot, jemi dëshmitarë të ndryshimeve të mëdha shoqërore, të cilat shkaktojnë probleme të mëdha. Njeriu bashkëkohor ndihet i huaj, përjeton ndjenjën e absurdit madje edhe ankthin. Çfarë duhet të bëjë njeriu i sotëm për të gjetur kuptimin e ekzistencës së tij? Cila do të ishte zgjidhja? Përgjigjja mund të jetë nga filozofia ekzistencialiste e cila përshkruan kuptimin e jetës dhe përpiqet të gjejë zgjidhje për dëshpërimin njerëzor. Kjo është filozofia që mbizotëroi mendimin letrar francez në shekullin XX. Sartri dhe Kamy gjithmonë na mësojnë se njeriu është i dënuar të jetë i lirë dhe se ai është përgjegjës për veprimet e veta.

Jeta përbëhet nga zakone të përditshme, të cilat janë të zhveshura nga kuptimi i vërtetë. Thjesht njohja e absurditetit të veprimeve tona është ajo që na trondit dhe e zgjon vetëdijen tonë të përgjumur. Thënë ndryshe, njeriu modern duhet të revoltohet apo të angazhohet për të qenë në gjendje të kuptojë rrethanat me të cilat përballet. Koncepti i absurditetit ishte i ngjashëm në shumë aspekte si te Kamy, edhe te Sartri.

Për Sartrin, absurditeti është gjendje e mjerë, por është gjithashtu edhe fat. Është pikënisje, diçka që duhet të tejkalohet nga vullneti i individit, duke i caktuar qëllimin e ekzistencës. Ndërsa, Kamy, gjatë gjithë jetës, ishte shqetësuar për problemin e vetëvrasjes dhe për keqkuptimin se qeniet jetojnë pa vullnetin e tyre. Madhështia e njeriut për Kamynë është treguar në jetën me plot vetëdije se jeta është absurde. Revolta është vendim i individit, është përgjigje ndaj shtypjes, padrejtësisë e keqkuptimit. Ajo është e brendshme dhe subjektive.

***Fjalët kyçe:** Ekzistencializmi, poetika, romani, Sartri, Kamy, angazhimi, ekzistenca, absurdi, revolta.*

## **Summary**

Today, we are witnessing great social changes, which are causing great problems. Contemporary man feels the experiences of the absurdity and even anxiety. What must man do today to find the meaning of his existence? What would be the solution? The answer may be from existentialist philosophy which describes the meaning of life and tries to find solutions to human despair. This is the philosophy that dominated French literary thought in the twentieth century. Sartre and Camus always teach us that man is doomed to be free and that he is responsible for his own actions.

Life consists of daily habits, which are devoid of true meaning. Simply recognizing the absurdity of our actions is what shocks us and awakens our drowsy consciousness. In other words, modern man must revolt or commit to being able to understand the circumstances he faces. The concept of absurdity was similar in many respects to both Camus and Sartre.

For Sartre, absurdity is a miserable condition, but it is also luck. It is the starting point, something that must be overcome by the will of the individual, setting the purpose of existence. Whereas, Camus, all his life, was worried about the problem of suicide and the misunderstanding that beings live without their will. Man's greatness for Camus has been shown in life with full awareness that life is absurd. Revolt is the decision of the individual, it is a response to oppression, injustice and misunderstanding. It is internal and subjective.

**Key words:** *French existentialism, poetics, novel, Sartre, Camus, existence, revolt, absurdity.*